

Emër Mbiemër	<b>MARK TIRTA</b>
Datëlindje	<b>21.05.1938</b>
Vendlindje	<b>Orosh, Mirditë</b>
Viti i zgjedhjes	<b>2008</b>
Seksioni	<b>Shkencat shoqërore dhe albanologjike</b>
Gjuhët	<b>Rusisht, italisht, frëngjisht, serbokroatisht</b>

### **Kontakt**

---

Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku", Pall. 55, Ap.7-8.

Telefon: 042243494 ; cel: 0682940689

Email: mtirta@yahoo.com

Faqe zyrtare: [www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

### **CV e shkurtër**

Etnolog, profesor, akademik i asociuar. Kreu studimet e larta në degën histori-gjuhësi të UT (1961). Në vitin 1961–1968 punoi në arsim në rrethin e Mirditës. Në vitin 1968 filloi punën në sektorin e etnografisë të *Institutit të Historisë* dhe prej vitit 1979 në *Institutin e Kulturës Popullore*. Mark Tirta është marrë kryesisht me migrimet e popullsisë shqiptare dhe me mitologjinë popullore, por ka studiuar edhe problemet e familjes, të veshjeve, të së drejtës dokesore, të toponimisë e antroponimisë, artin e zbatuar popullor, historinë e etnologjisë shqiptare dhe personalitetet e saj etj. Mbi këto tema ka shkruar mbi 300 punime shkencore e kulturore. Ka marrë pjesë në shumë ekspedita në vise të ndryshme shqiptare. Njihet si një ndër studiuesit më në zë të problemeve të etnokulturës shqiptare. Ka shkruar mbi 300 punime shkencore e kulturore në fushë të etnologjisë shqiptare e më tej. Ka marrë pjesë me mbi 100 kumtesa në sesione shkencore, simpoziume, konferenca, në kongrese shkencore kombëtare e ndërkombëtare, brenda e jashtë vendit. Rreth 42 punime shkencore të këtij etnologu janë botuar në gjuhë të huaja. Është marrë dhe me muzeologji: në ekspozita e muze në Tiranë, në rrethe të ndryshme të vendit, në ekspozita muzeale e veprimtari jashtë vendit. Mark Tirta është vlerësuar me shumë tituj e dekorata të ndryshme.

### **Publikime (Monografi, Vepra kolektive, Përmbledhje studimesh)**

1. **“Lëvizjet migruese të shqiptarëve, të brendshme e në popujt më afër”** (AShSh), Tiranë, **2013**, 344 f.; ISBN: 973-99956-10-60-9.

2. **“Panteoni e simbolika, doke e kode...”** (AShSh, IKP), Tiranë, **2007**, 376 f.; ISBN: 978-99956-10-4-3.
3. **“Mjeshtëria e kërkimit shkencor në etnologji”**, (AShSh, IKP), Shtëpia botuese “Ilar”, Tiranë **2006**, 162 f.
4. **“Mitologjia ndër shqiptarë”** (AShSh, IKP), Shtëpia botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë **2004**, 452 f.; ISBN: 99927-938-9-9.
5. **“Etnologjia e shqiptarëve”** (AShSh, IKP), Tiranë, “Geer” **2003, 2006**, 540 f.; ISBN: 99927-937-9-7.
6. **“Etnologjia e përgjithshme”** (AShSh, IKP), Tiranë, “Geer” **2001, 2008**, 298 f.; ISBN: 99927-753-5-1.
7. **“Migrime të shqiptarëve”, “Etnografia shqiptare”**, (AShSh), Tiranë **1999**, 210 f.
8. **“Mitologji e besime ndër shqiptarë”, Manual shkencor**, (AShSh, IH), Tiranë **1973**, 76 f.
9. **“Mitologji e besime”**, Libër universitar, Tiranë **1970**, 66 f.

Me bashkautorë

1. **“Tradita kulturore e Hasit”**, Prishtinë, “Dukagjini” **2007**, 285 f.
  2. **“Veshjet popullore shqiptare”**, Vëll. II, Selanik **2001**, 210 f.
  3. **“Mirdita njohuri për vendlindjen”**, Tiranë, “Geer”, **1999**, 202 f.
  4. **“Mirdita në histori dhe në etnokulturë”**, Tiranë, “Geer”, **2001**, ISBN: 99927-654-6-1.
  5. **“Veshjet popullore shqiptare”** Vëll. I, (AShSh, IKP), Milano **1999**, 210 f. ISBN: 99927-654-6-1.
- Ka botuar mbi 100 artikuj shkencorë e kulturorë si dhe një numër shumë të madh kumtesash, kryesisht të fushës së etnologjisë, të mbajtura në konferenca e simpoziume shkencore brenda e jashtë vendit.